



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:144493

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05745561

Ac.nr.3106/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.K, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati H.N, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “D”, të cilën e përfaqëson i autorizuari V.R, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.1151/16 e datës 09.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 23/05/2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET pjesërisht ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “D” si e pa themeltë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.1151/16 e datës 09.02.2021, në pikën I të dispozitivit lidhur me kompensimin e dëmit jo material: për dhimbje fizike, për frikë, për shëmtim si dhe për kompensimin e dëmit material: për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë, për ushqim të përforcuar dhe për shpenzimet e shërimit, VËRTETOHET.

II.APROVOHET pjesërisht ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “D”, si e themeltë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.1151/16 e datës 09.02.2021 në pikën I të dispozitivit lidhur me kompensimin e dëmit jo material për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshme jetësore dhe kjo kategori e dëmit gjykohet si në vijim: Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “D”, që paditësit S.K, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshme jetësore t’ia paguaj shumën prej 4,000 euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e gjykuar refuzohet si e pa bazuar.

III.Aktgjykimi ankimuar C.nr.1151/16 e datës 09.02.2021, në pikën II dhe III të dispozitivit, mbetet e pa shqyrtuara.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin ankimor C.nr.1151/16 e datës 09.02.2021, ka vendosur si vijon: PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditësit S.K, ashtu që:

I.DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve „D”, që paditësit në emër të zhdëmtimit, si pasoj e lëndimit trupor në aksidentin rrugor të dt.29.10.2016, t’ia paguaj, shumat e specifikuara si më poshtë, dhe atë:

-në emër të dëmit jo material:

- për zhdëmtimin në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike shumë prej 4.000€,
- për zhdëmtimin në emër të zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë shumë prej 6.000€,
- për zhdëmtimin në emër të frikës së përjetuar shumë prej 3.000€,
- për zhdëmtimin në emër të shëmtimit shumë prej 1.500€.

-në emër të dëmit material:

- për ndihmë dhe kujdes të huaj shumë prej 600€,
- për ushqim të përforcuar shumë prej 900€ dhe
- për shpenzime të mjekimit shumë prej 897,37€ €.

II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit S.K, përtej shumës së gjykuar, për kompensimin e dëmit jo material, dhe atë: në emër të dhembjeve fizike shumë prej 3.000€, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë shumë prej 4.000€, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 2.000€, në emër të shëmtimit shumë prej 2.500€, SI E PA BAZUAR.

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve „D”, që shumat e gjykuara si në pjesën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguaj paditëses me kamat kamatë prej 8% në vit, duke filluar nga dt.16.02.2021, si ditë e vendim marrjes e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1.972,80€, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuari i të paditurës, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe të zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në ankesë.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i autorizuari i paditësit.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në gjykatën e shkallës së parë, me datën 19.12.2016 ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “D”, për kompensim demi, me kërkesë të precizuar si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk ishte kontestues fakti se deri te aksidenti ka ardhur me fajin ekskluziv të drejtuesit të siguruarit të paditurës, po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se paditësi i është nënshtruar shërbimeve mjekësore shëndetësore pranë institucioneve përkatëse dhe nga ekspertiza mjekësore e punuar nga grupi i eksperteve Dr. Xh.S, Dr.V.B, dhe Dr. Sh.H, që të gjithë ortoped-traumatolog dhe eksperti Dr.M.H-neuropsikiatër, është vërtetuar se paditësi, në aksidentin e datës 29.10.2016, ka pësuar lëndime të rënda trupor të përshkruara si në arsyetimin e aktgjykimit dhe shumat e caktuara të kompensimit janë në proporcional me lëndimet e pësuar

trupore. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 183 dhe 382 të LMD-së dhe neneve 449, 452 par.1 dhe 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i të paditurës për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadsisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimore të paditurës për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë sa i përket pjesës vërtetuese, sepse në bazë të provave të administruara, nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadsisë se deri te aksidenti i ndodhur me datën 29.10.2016, ka ardhur si rezultat i lëshimeve të siguruarit të paditurës, e po ashtu si pasoj e këtij aksidenti e paditura nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësi ka pësuar lëndime të renda trupore, e të cilat lëndim janë manifestuar me dhembje fizik dhe frikë, ashtu siç kanë konstatuar edhe ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional, dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: “Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor”, në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë. Në këtë rast e paditura në seancën e shqyrtimit kryesor edhe pse e ka kundërshtuar pjesërisht lartësinë e kërkesëpadsisë e njëjta me asnjë provë bindëse nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia, edhe pse ka pasur për detyrë ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të nenit 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të lartcekura e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë lidhur me lartësinë e kompensimit si në pjesën vërtetuese, gjykata është e mendimit se e njëjta është adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit si dhe shkallën e të mirës nga e cila ai i është privuar dhe se lartësia e shumë të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj të dëmtuarit- këtu paditësit, satisfaksion që ai me këto mjete t'i riparojë në një masë nevojat e tij materiale, respektivisht lartësia e kompensimit të dëmit është në harmoni edhe me Udhëzimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë se shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material Gj.A.nr.41/2023 e dt.27/02/2023, prandaj gjykata e shkallës së parë drejt i ka aplikuar dispozitatat materiale të paraparë me nenin 136, 159, 169, 174, 179, dhe nenin 183 të LMD-së. Andaj në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur pjesërisht si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadsisë.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket dëmit jo material për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, Gjykata e Apelit ka gjetur se ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë dhe si rezultat e ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të nenit 195 paragrafi 1 pika e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, sepse nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, ngase shuma e aprovuar për këtë kategori të dëmit ishte e lartë, në raport me lëndimet e pësura trupore si dhe nuk ishte në harmoni me Udhëzimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë se shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material Gj.A.nr.41/2023 e dt.27/02/2023, duke pasur parasysh se në rastin konkret është provuar me ekspertizën mjekësorë se zvogëlimi i aktivitetit jetësor të paditësit të pësuar në aksidentin e komunikacionit është 9.75% dhe mbi këtë bazë Gjykata e Apelit e caktoj lartësinë e kompensimit si në dispozitivin e këtij aktvendimi, duke vlerësuar se ky kompensim përfaqëson një satisfaksion adekuat që i dëmtuari (në këtë rast paditësi) t'i përballojë më lehtë dëmet jo materiale të pësura në aksident si dhe të bëjë rehabilitimin e tij mjekësor.

Pika II dhe III e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, nuk është shqyrtuar nga kjo gjykatë, pasi që në bazë të thënieve nga ankesa e ushtruar, kjo gjykatë ka konstatuar se në këtë pjesë aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur nga palët ankuese.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet tjera janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e) e lidhur me nenin 201 pika d) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.3106/21, me datë 23/05/2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku